
RR 765 844 915 AA

3. Lejohet paditësja të mbajë mbiemrin e saj martesor Shaholli edhe pas zgjidhjes së martesës.
4. Një kopje e vendimit i dërgohet Bashkisë Devoll, Njësia Administrative Hoçisht, Zyra e Gjendjes Civile 275 për të kryer veprimet administrative sipas ligjit, pasi vendimi të këtë marrë formë të prerë.
5. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për këtë vendim i cili ekzekutohet nga shërbimi përmbarimor.
6. Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të palës paditëse.
7. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
8. **U shpall në Korçë me datë 06.12.2024**

SEKRETARE
LUBIANA KINOLLI

GJYQTAR
SUZAN BUSHI

Shpenzime gjyqësore	Pala qe ka parapaguar/paguar shpenzimin gjyqësor				Sasi	Çmimi	Vlerë
	Gjykata	Paditës	I Paditur	P. Tretë			
Tarife Gjyqësore		+			1	3000	3000
Shpenzime për njoftime		+			1	150	150
Shuma							**3150**

Me martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime.
Nga martesa lind detyrimi reciprok për ***besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës.***

Nga këto përcaktime dhe për mënyrën sesi palët kanë vendosur të vazhdojnë jetën e tyre pasi kanë shkuar në shtetin grek për të jetuar, arrijmë të kuptojmë se ato nuk kanë dashur të sillen sikur janë në një martesë që ka formën e "bashkësisë ligjore" mes tyre, duke ndihmuar njeri tjetrin me kontributet e tyre dhe të ardhurat që realizonin, por duke mbajtur secili të ardhurat që realizonin nga punët e tyre respektive dhe duke u përgjigjur mekanikisht mbi shpenzimet për jetën e përbashkët, ku të dyja palët ndanin shpenzimet për jetës, si dhe për vajzën e tyre.

Jo vetëm kaq, por pala paditëse pretendon se i padituri gjatë kësaj kohë kishte krijuar një lidhje jashtëmartesorë me një person tjetër dhe kishte braktisur jetën e përbashkët bashkëshortore dhe nuk kërkonte me të kthehej në banesën familjare, duke ndërprerë dhe jetesën përbashkët *(neni 55 i Kodit të Familjes).*

Nga të gjitha elementet e përmendur me sipër gjykata arrin në përfundimin se kjo marrëdhënie martesore duhet zgjidhur dhe se gjykata do të duhej të shprehej në lidhje me pasojat ligjore që kjo zgjidhje përmban në vetvete, duke mos parë asnjë mundësi rikuperimi mes palëve.

Në gjykim pala paditëse kërkoi pranë gjykatës që me zgjidhjen e martesës të mbante mbiemrin martesor që ajo ka marrë gjatë martesës atë "Shaholli", pasi i gjithë dokumentacioni i saj pranë shtetit Grek (karta e rezidencës dhe çdo gjë tjetër) janë me mbiemrin Shaholli, dhe ndryshimin i mbiemrit për shkak të martesës do të përbënte një kosto ekonomike mjaft të madhe për të.

Jo vetëm kaq, por dhe fakti që vajza e tyre madhorë Drita Shaholli është me të njëjtin mbiemër, pala paditëse kërkon që mbajtja e të njëjtit mbiemër si dhe vajza e saj do t'i jepte me tepër mundësi palës paditëse të kishte të njëjtin identifikim familjar me të.

Gjykata shprehet se kjo kërkesë është në përputhje me parashikimet nenit 146 të Kodit të Familjes, i cili thotë se:
Bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës.
Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës.
Gjykata çmon se një kërkesë e tillë është në interes të bashkëshortit paditës por dhe në interes të fëmijës së saj pasi krijon një identifikim familjar të njëjtën me nënën e saj, paditëse në këtë proces.

Përfundimisht në bazë të neneve 126, 306 e vijues të K. PR. Civile dhe neneve 132 dhe 146 të Kodit të Familjes, gjykata

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesë padisë.
2. Zgjidhjen e martesës ndërmjet palës paditëse Alketa Shaholli dhe palës së paditur Agron Shaholli.

3. VLERESIMI I GJYKATËS.

Gjykata vëren se, ligjvënësi shqiptar, nga njëra anë, duke pasur parasysh se një marrëdhënie bashkëshortore, respektivisht një martesë, mund të humbasë qëllimin e saj dhe të shndërrohet në një raport juridiko-formal, duke u kthyer në një pengesë të lirisë së vullnetit të bashkëshortëve, dhe si e tillë, në një pengesë e zhvillimit të lirë të personalitetit njerëzor dhe nga ana tjetër, duke dashur të mbrojë veçanërisht martesën, përmes kufizimit racional të shkaqeve për të cilat ajo mund të zgjidhet, ka parashikuar në Kodin e Familjes disa shkaqe ligjore për të cilat mund t'i jepet fund një marrëdhënieje ligjore martese, duke i parashikuar ato në mënyrë shteruese dhe kufizuese sipas neneve 125, 129 dhe 132 e vijues të Kodit të Familjes.

Konkretisht, një ndër mënyrat se si mund të zgjidhet martesa **është padia e njërit bashkëshort** dhe mjeti përkatës procedural me të cilën arrihet kjo është kërkesëpadia e njërit bashkëshort, sikurse mjeti që ka vënë në lëvizje gjykatën palët ndërgjyqëse.

Në referim të nenit 132 të KF, secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, **shkeljes së besnikërisë bashkëshortore,** sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit **ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesa, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj** për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët.

Për sa me sipër, gjykata pasi ka relatuar se përpjekjet për pajtim u shteruan nga ana e gjykatës, dhe duke qenë se pala e Paditur nuk ka dashur të jetë i pranishëm gjatë gjykimit, si në seancë të pajtimit por edhe me tej, gjykata ka vlerësuar se bazuar në pretendimet e paditëses dhe provat e sjella prej saj kjo martesë duhet zgjidhur, pasi është e vetmja formë për ti dhënë fund një raporti martesor që karakterizohet nga dhuna që pala e paditur ka ushtruar në vazhdimësi ndaj paditëses,.

Në rastin në gjykim, pala paditëse Alketa Shaholli ka pretenduar përpara gjykatës për mënyrën sesi është njohur me palën e paditur, Agron Shaholli, dhe sesi ka qenë raporti i tyre martesor deri përpara sesa ky i fundit të braktiste jetën bashkëshortore që kishte me paditësin. Sipas paditësit, ai është larguar me një partner tjetër tashmë, duke i dhënë fund de facto jetesës se tyre të përbashkët.

Por sipas saj, paditëses, mosmarrëveshjet kishin filluar që kur pala e paditur ka filluar të këtë pretendime në lidhje me të ardhurat që paditësja realizonte në shtetin Grek gjatë krizës ekonomike që ky vend ka kaluar me parë. Këto mosmarrëveshje i kishin çuar palët që të gjenin një zgjidhje me marrëveshje që secili prej tyre të ardhurat që realizonte nga puna e tij/saj t'i depozitonte në një llogari me vete dhe shpenzimet që kryenin qoftë për jetesën e përditshme, por dhe ato në lidhje me vajzën e tyre t'i ndanin në mënyrë të barabarte.

Kjo lloji sjellje e palëve, megjithëse me marrëveshje, ka sjell një gjendje e cila është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 50 të Kodit të Familjes dhe regjimit martesor që palët kanë patur për shkak të ligjit, atë të "bashkësisë ligjorë". Sipas nenit 50 të Kodit të Familjes thuhet se:

paditësit për zgjidhjen e martesës ishte real dhe i lirë dhe se, **nuk kishte asnjë mundësi pajtimi** midis palëve, pasi marrëdhëniet e tyre ishin tronditur deri në atë masë sa e bënte të pamundur jetesën e tyre të përbashkët, duke qenë se pala e paditur kishte braktisur ambientin familjar prej kohesh. Në këto kushte, kjo gjykatë mori në shqyrtim pretendimet e palëve **në seancë gjyqësore**, duke vlerësuar faktet dhe provat e paraqitura nga palët në krahasim me ligjin e aplikueshëm.

2. RRETHANAT E ÇËSHTJES.

Unë paditësja Alketa Shaholli i jam drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për të zgjidhur martesën ligjore me Agron Shaholli.

Si fillim, palët kanë jetuar në qytetin e Tiranës, pastaj 6 muaj në fshatin Cipan në banesën e prindërve të të padituri. Gjatë kësaj kohë pala paditëse ka ngelur shtatzënë me fëmijën që ka me të padituri, dhe lindja e vajzës ka ndodhur në Greqi. Martesa është lidhur në datën 04.07.2007 në Konsullatën Shqiptare në Athinë dhe regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile Hoçisht. Nga kjo martesë kanë ardhur në jetë një vajzë me emrin Drita Shaholli e cila është madhore 18 vjeç e 8 muaj gjete zhvillimit të procedurës objekt gjykimi..

Sipas pretendimit të paditëses, në fillim të martesës çdo gjë shkonte shume mirë, por duke qenë se në shtetin Grek ra kriza ekonomike e viteve 2010 pala paditëse ka qenë e vetmja që ka punuar, ndërkohë që i padituri nuk punonte.

Ky fakt u be shkak për grindje të vazhdueshme mes çiftit dhe me marrëveshje secili mbante për vete rrogën e tij në llogari të ndryshme bankare dhe shpenzimet për shtëpinë, qiranë, ushqimet apo studimin e vajzës i ndanim ne mes.

Kohet e fundit paditësja ka mësuar nëpërmjet vajzës së saj se i padituri e tradhton me një grua tjetër. Vajza i ka parë dhe ka parë dhe mesazhet që i dërgon në telefon. Këtë fakt e ka lënë të kuptohej dhe në familje dhe më ka ofenduar disa herë duke me thënë që nuk me duron dot. Përderisa i padituri është ftohur nuk ka asnjë arsye që të jetojmë më bashkë të martuar.

Ka 2 javë që është larguar nga shtëpia pas një debati që bëmë dhe ka shkuar të jetojë me zonjën që më tradhton. Ky fakt më ka prekur shumë psikologjikisht dhe mua dhe vajzën. Ndihem e ofenduar nga i padituri ky fakt e ka tronditur shume marrëdhënien bashkëshortore.

Për sa më sipër duke qenë se martesa mes palëve nuk funksionon dhe e ka humbur qëllimin e lidhjes se saj, nuk ka më harmoni dashuri në këtë martesë dhe marrëdhëniet janë tronditur shumë për shkak të tradhtisë dhe ofendimeve të vazhdueshme, pala paditëse i drejtohet me kërkesëpadi Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë duke kërkuar: zgjidhjen e martesës.

Me qenë se paditësja gjithë dokumentacionin në shtetin Grek e kam me mbiemrin Shaholli kërkon të mbaj mbiemrin pas martesor **Shaholli** bazuar në nenin 146 K.F pasi i krijohet një dem ekonomik që gjithë dokumentacionin ta kthejë përsëri në mbiemrin paramartesor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Nr. Regj. Them. 21001-01345-41-2024(1969) **Nr. vendimi 41-2024-4217(1183)**
Data e regjistrimit 09.10.2024 **Data e vendimit 06.12.2024**

VENDIM
"Në emër të Republikës"

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e përbërë nga gjyqtari i vetëm:

Gjyqtare
SUZAN BUSHI

Në Korçë, sot më date 06.12.2024, prani të sekretare gjyqësore Lubiana Kinolli mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore çështjen civile me Nr. Regj. Them **21001-01345-41-2024(1969),** që i përket:

PADITESE: **Alketa Shaholli** e bija e Bashkim dhe e Yllke lindur në datë 05.11.1977 në Shëngjergj Korçë dhe banuese në Cipan Devoll momentalisht me vendqëndrim në Athinë Greqi. Të njoftohem te shtëpia e prindërve Bashkim Lamlli në fshatin Shëngjergj, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.

I PADITUR: **Agron Shaholli** i biri i Hekuran dhe e Rita lindur në Cipan Bilisht dhe banues në Cipan Devoll. Të njoftohej te shtëpia e vëllait të tij Xhevdet Shaholli në fshatin Cipan, Njësia Administrative HHocisht, Bashkia Devoll.

OBJEKTI: Zgjidhja e martesës ligjore e dt.4.07.2007 midis paditëses dhe të paditurit, dhe rregullimin e pasojave te tjera si pasoje e zgjidhjes se marteses

BAZA LIGJORE: Neni 132 e vijues i Kodit të Familjes.

Gjykata pasi shqyrtoi dhe analizoi në tërësi provat shkresore të depozituara nga pala paditëse;

VËREN

1. **PROCEDURA**

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është regjistruar kërkesë padia me palë dhe objekt si më sipër.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të padisë, gjykata analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e çështjes dhe në bazë të neneve 36 (1), 349 dhe 51 dhe 59 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Në bazë të nenit 134-135 të K. Familjes, gjykata bëri të gjitha përpjekjet e saj për pajtimin e palëve. Gjykata, pasi dëgjoi palën vetëm palën paditëse pasi pala e paditur nuk u paraqit asnjëherë gjatë procesit megjithëse u thirr nga ana e gjykatës, krijoi bindjen se vullneti i

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, më 21.03.2025

BASHKIA MA...
Zyra e Prot...
Nr. 1901 Pr...
Date 27.3.25 ...

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar : Njesise Administrative Pojan Bashkia Maliq

Për shtetasen : Alketa Shaholli
Me adresë: Shengjergj Njesia Administrative Pojan Bashkia Maliq

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 1183 dt. 06.12.2024 për t'u afishuar nga ana juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor,* pasi dëftesa e komunikimit është kthyer me shënimin : " Larguar " dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot në datë ----------
Për Njesine Administrative Pojan

(emër, mbiemër, firmë)

- Pj-A-Pojan
- ST IMP
dt 27.03.2

101